



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3555/11 prot.

Datë 29.01.2026

V E N D I M

Nr. 168.2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga,

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2026 mori në shqyrtim çështjen me

Objekt: Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. 20/2026, datë 07.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjete mije e nentëdhjete e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë

Kërkuesi: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, dëgjoi relatorin e çështjes, e pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 01.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mije e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

I.2. Në datën 10.11.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

I.3. Në datën 02.12..2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “KRIJON” SHPK	17,171,171 lekë	s’kualifikuar
2. “GAMMA” SHPK	17,900,000 lekë	kualifikuar
3. “AlMedical” SHPK	24,888,880 lekë	kualifikuar
4. “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK	21,367,162.71 lekë	s’kualifikuar
5. “BionicTech” SHPK	16,944,553.32 lekë	s’kualifikuar
6. “MEDFAU” SHPK	18,756,768.29 lekë	s’kualifikuar
7. “ISOMETRIC” SHPK	0 lekë	s’kualifikuar

I.4. Në datën 05.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

I.5. Në datën 11.12.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK me numër ankimimi elektronik A/2025/6171, datë 11.12.2025 dhe me Nr. 3555/2025 Prot., datë 11.12.2025 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike

I.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3555/1 prot., datë 12.12.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KRIJON” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3555 prot, datë 11.12.2025.

I.7. Në datën 14.12.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6180, datë 14.12.2025 dhe me Nr. 3581/2025 Prot., datë 15.12.2025 e operatori ekonomik “BionicTech” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike

I.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3581/1 prot., datë 16.12.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “BionicTech” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3555 prot, datë 11.12.2025.

I.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 4251/4 prot., datë 19.12.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3555/2 prot., datë 22.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në rrugë elektronike vendimi i KSHA-së nr.155/2025.

I njëjti vendim është përcjellë nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.4251/5 prot., datë 19.12.2025, protokolluar me tonën nr.3555/3 prot., datë 22.12.2025.

Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

I.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se më datë 22.12.2025 është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

I.11. Njëpërmjet shkresës me nr. 4251/8 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3581/2 prot., datë 24.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në rrugë elektronike vendimi i KSHA-së nr.158/2025.

I njëjti vendim është përcjellë njëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.4251/9 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën nr.3815/3 prot., datë 29.12.2025.

Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

I.12. Me datë 07.01.2026 KPP mori vendimin nr. 20/2026 ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “ BionicTech” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRIJO ” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.13. Me shkresën nr.374 prot, datë 26.01.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr.20/2026. Datë 07.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 3555/9 prot., datë 28.01.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka dorëzuar pranë KPP kërkesën për rishikim të vendimit 20/2026, datë 07.01.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

II.1.1. Me shkresën nr.374 prot, datë 26.01.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr.20/2026. Datë 07.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 3555/9 prot., datë 28.01.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka dorëzuar pranë KPP kërkesën për rishikim të vendimit 20/2026, datë 07.01.2026, duke pretenduar ndër të tjera:

[...] Pasi është njohur me vendimin e KPP, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Vetëmbrojtjes, në cilësinë e autoritetit porositës dhe përdorues i artikujve object prokurimi, ka dërguar një email duke theksuar papërshtatshmërinë teknike të artikujve të paraqitur dhe domosdoshmërinë e respektimit të plotë të specifikimeve teknike të kërkuara.

Për sa më sipër, duke qenë se artikujt e ofruar nga operatori ekonomik “Bionictech” SHPK nuk plotësojnë specifikimet teknike kërkojnë rishikimin e vendimit nr.20/2026, datë 07.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit me objekt , Loti 4: ‘Blere enë laboratorike’ me fond limit 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh” [...]

II.1.2. KPP në lidhje me vendimarrjen gjykon se ligjvënësi ka parashikuar rregulla strikte mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 24/3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon “Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritit.”

Lidhur me argumentat e paraqitura në kërkesën tuaj ju sjellim në vëmendje se KPP, nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj e argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit. Gjithashtu KPP, sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor, se neni 30, pika 2, e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar thekson: “2. “Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë kërkesën e autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, për rishikim të vendimit të KPP nr.20/2026, datë 07.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

